

VENDIM
Nr. 595, datë 9.10.2018

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2018, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109, datë 30.12.2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, bëhen ndryshimet si më poshtë vijnë:

a) Në programin buxhetor “Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes” 04240, shtohet fondi prej 165 000 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekësh, në zërin “Shpenzime kapitale” dhe 28 964 000 (njëzet e tetë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) lekësh në “Shpenzime korrente” (art. 602), për operimin dhe rehabilitimin e objekteve të infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja;

b) Në programin buxhetor “Zhvillimi rural” 04250, pakësohet fondi prej 165 000 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekësh në zërin “Shpenzime kapitale” dhe prej 864 000 (tetëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) lekësh në “Shpenzime korrente” (art. 602);

c) Në programin buxhetor “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit” 04220, pakësohet fondi prej 21 000 000 (njëzet e një milionë) lekësh në zërin “Shpenzime korrente” (art. 602);

ç) Në programin buxhetor “Këshillimi dhe informacioni bujqësor”, 04860, pakësohet fondi prej 7 100 000 (shtatë milionë e njëqind mijë) lekësh në zërin “Shpenzime korrente” (art. 602).

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama